

VENDIM
Nr. 329, datë 18.4.2013

PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË BILETËS SË CIRKUT KOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së biletës së Cirkut Kombëtar, institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha